



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:239473
Datë: 12.09.2024
Numri i dokumentit: 06154172

C.nr.3794/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil, gjyqtarja Diora Bajrami, në çështjen juridike kontestimore të paditëses V.K.S. nga Prizreni me numër personal të cilin me autorizim e përfaqëson av. A.H. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të kontestit kompensimin e diferencës së pagës së kualifikimit të pa paguar, vlera e kontestit 1,383.75 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 12.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses V.K.S. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimit të diferencës së pagës së kualifikimit të pa paguar.

II.DETYROHET e paditura, që paditëses, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, për periudhën kohore prej datës 01.11.2020 deri më datë 31.10.2022 apo për 24 muaj (për çdo muaj shumën prej 55.35 euro, në shkallë prej 27% të pagës 421.00 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), t'ia paguajë shumën prej 1328.4 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 02.11.2023 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

III. REFUZOHET si e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses V.K.S. nga Prizreni, përtej shumës së gjykuar si nën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë në shumën 55.35 euro.

IV.DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit-Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditëses t'ia paguaj shumën prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësja V.K.S. nga Prizreni, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av. A.H. nga Prishtina, pranë kësaj gjykate me datë 02.11.2023, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të kontestit kompensimin e diferencës së pagës së kualifikimit të pa paguar.

Në padi, pala paditëse ka theksuar se paditësja është e punësuar si mësimdhënëse pranë SH.F.M.U. “Lekë Dukagjini” në Prizren. Meqenëse paditësja është e licencuar dhe e ka kualifikimin e mësimdhënësit në nivelin bachelor me diplomë fakulteti, në bazë të nenit 7 të kontratës kolektive të datës 18.04.2017, të njëjtës i është garantuar e drejta në pagesën shtesë prej 27% të pagës bazë, çka e paditura këtë shtesë e paguan pjesërisht. Paditësja realizon pagën bazë prej 405 euro në muaj, ndërsa shtesën prej 27% e kësaj page apo shuma prej 109.35 euro e paditura ia paguan pjesërisht dhe atë në shumën prej 58.32 euro, duke i mbetur borxh shumën prej 51.03 euro, që nga 01.10.2020 deri më 01.02.2023.

Përmes parashtresës së dt. 22.01.2024, paditësja përmes të autorizuarit të tij ka kërkuar kompensimin e diferencës së pagës së kualifikimit të pa paguar prej 27% për periudhën kohore nga data 01.10.2020 deri me datë 31.10.2022, në shumë në lartësi prej 1,383.75 euro, llogaritur në pagën bazë që e njëjta e realizon në shumë prej 421.00 euro. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Prizrenit–Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarit të saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 02.02.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Pretendimet e paditësit se i takon kompensimi deri më datë 31.10.2022, janë të pa bazuara për arsye se në mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.214/2023, datë 05.10.2023, rastet e të punësuarve që kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit, duhet të trajtohen deri më datë 21.11.2022, kur kjo kontratë është shkëputur nga njëra prej palëve kontraktuese. Ka theksuar se në bazë të njoftimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit nr.01B/ të datës 21.11.2022, për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021 padia dhe kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar. Pretendimet e paditëses se i takon kompensimi për kualifikim dhe licencim është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Paditësi ushtron padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Pretendimet e paditësit se i takon beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës të R. Kosovës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Po ashtu ka theksuar se e drejta për kompensim të inflacionit prej vitit 2020 është parashkruar sipas nenit 353 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve sepse kanë kaluar mbi 3 vite. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës me numër protokollit 311/12, e datës 18.04.2012, për paditësen e

lëshuar nga Komuna e Prizrenit–Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, në SH.F.M.U. “Lekë Dukagjini” në Prizren, si mësimdhënëse klasore. Kualifikimi i paditëses fakultet, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me numër 1106, e datës 24.09.2014 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” në Prishtinë, në emër të paditëses, ku e njëjta ka marrë titullin Baqellor i mësimit klasor. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet lartësia e pagës bazë të paditësit e që është shuma prej 421.00 euro, dhe se paditëses në emër të kualifikimit fakultetit, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 58.32 euro.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se *“shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*. Andaj meqë këto dokumente janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që *“nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”*. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se *“mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”*. Pastaj, bazuar në mendimin juridik nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që *“për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008”*, vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditësit t’ia bëjë kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe kontrata e punës, rezulton se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, ia ka paguar shumën prej 58.32 euro paditëses. Sipas pikës 4 nën pikës 3 të Vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008, paditësja përfiton ngritje prej 27% të pagës bazë, që në rastin konkret e njëjta përfiton 113.67 euro për kualifikimin me fakultet, rrjedhimisht paditësja ia ka paguar shumën prej 58.32 euro ndërsa ka mbetur pa paguar diferencën prej 55.35 euro për muaj. Andaj, gjykata vendosi si në pikën nën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditëses për çdo muaj t’ia paguaj shumën prej 55.35 euro apo diferencën e mbetur, për 24 muaj nga data 01.11.2020 deri më datë 31.10.2022, në shumë të përgjithshme prej 1328.4 euro (24 x 55.35 = 1328.4 euro), duke e llogaritur sipas pagës në shumën prej 421.00.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata vendosi duke iu referuar nenit 398 të LPK-së, ku parashihet që: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, andaj ka vendosur si në pikën nën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese si në pikën nën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadsisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”*, pasi që gjykata e vlerësoi të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të Ligjit të Punës, ku shprehimisht theksohet që *“të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Në këtë drejtim, paditësja padinë pranë kësaj gjykate e ka parashtruar më datë 02.11.2023. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditësja iu ka parashkruar pjesa e kërkesës nga data 01.10.2020 deri më datë 31.10.2020. Më konkretisht, sipas llogaritjes së gjykatës, një kërkesë e tillë është parashkruar për 1 muaj ndërsa paditësja e ka ndërprerë rrjedhjen e parashkrimit dhe e ka ruajtur të drejtën për të kërkuar realizimin e kërkesës së saj në procedurë gjyqësore nga data e paraqitjes së padsisë, andaj mbi bazën e parashkrimit për një muaj (01.10.2020 deri më datë 31.10.2020) të njëjtës iu refuzua shuma prej 55.35 euro.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashkrimit të padsisë më datë 02.11.2023, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritore.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padsisë në shumën prej 104.00 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 euro. Gjykata nuk i ka aprovuar shpenzimet tjera të kërkuara, përkatësisht për precizimin e padsisë meqenëse kompensimi caktohet vetëm për shpenzimet e krijuara lidhur me lëndën në gjykatë. Për më tepër nuk mund të kërkohej kompensim për secilën parashtrësë të deponuar në gjykatë e posaçërisht jo lidhur me parashtrësën e dorëzuar sipas aktvendimit për plotësimin e padsisë, duke qenë se parashtrësja gjegjësisht padia fillestare ka pasur të meta.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në pajtim me nenin 143 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së.

Numri i lëndës: 2023:239473
Datë: 12.09.2024
Numri i dokumentit: 06154172

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil
C.nr.3794/2023 datë 12.09.2024

Gjyqtarja

Diora Bajrami

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.